

Abstrakt

Karakteri kontraktual i marrëdhënieve të Republikës së Kosovës me Unionin Evropian është shumëdimensional që tëheq pas vetës të drejta dhe detyrime thuajse për të gjitha sferat e marrëdhënieve shoqërore dhe me gjerë. Ndërlidhur me këtë kontekst, ky punim përpiqet të jap një rezultat të fokusuar mbi një fushë mjaftë të rëndësishme e që lidhet përgjithësisht sundimin e ligjit konkretisht me rolin e Këshillit Prokurorial të Kosovës në realizimin e sfidave dhe zotimeve të dala nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Kosovës dhe UE-së.

Për të ardhur deri të një rezultat i konkretizuar i këtij hulumtimi, janë trajtuar çështje që lidhën me historikun e UE-së, politikat e Unionit, relacionet e e Unionit me Ballkanin Perëndimor përfshirë këtu një varg burimesh dhe dokumentësh nga ato strategjike deri te ato praktike si: Strategjia Kombëtare për Integritet Evropiane, MSA-ja, Ligjet për KPK, Raportet e progresit për Kosovën, draft ligjet aktuale për KPK dhe opinionet e Komisionit të Venecias për këto draft ligje etj.

Nga shtjellimi i temave dhe dokumenteve si më sipër ky punim nxjerrë në pah pjesët vijuese që në mënyrë konkrete paraqesin rolin dhe rëndësinë e KPK-së në përmbushjen e zotimeve të dhëna në MSA ndërmjet Kosovës dhe UE-së dhe duke argumentuar hipotezat e ngritura përmes një përfundimi të konsoliduar duke pasqyruar edhe rekomandimet përkatëse te këtij hulumtimi.